



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 24.05.2023

Nr: 134

Ora: 14:45

**VENDIM**

**PËR PUSHIMIN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 72, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR  
NGA Z. LAME JAUPAJ**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 24.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Z. Lame Jaupaj, kandidat për anëtar i këshillit bashkiak në bashkinë Memaliaj, nga lista shumëemërore e subjektit zgjedhor “Aleanca Progresite LZHK”.

**OBJEKT:** Rinumërim të kutive të Këshillit bashkiak për KZAZ nr. 78, Memaliaj.



**BAZË LIGJORE:** Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

#### **Rrethanat e çështjes:**

1. Z. Lame Jaupaj ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila është regjistruar në regjistrin përkatës me nr. 72 regj., datë 22.05.2023. Në seancën paraprake të datës 23.05.2023, ora 14:05, KAS konstatoi se kjo kërkesë ankimore ishte me të meta pasi nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor. Ankimuesi nuk gëzon legjitimitet për të paraqitur kërkesë ankimore në KAS, sepse atë mund ta paraqesë subjekti zgjedhor (partia) pjesë e listës të së cilës është edhe ankimuesi.
2. Z. Jaupaj, i cili ishte prezent në seancë, iu bë i qartë ky fakt dhe u orientua që të plotësojë edhe elementet e tjera formale si: vendimin e KZAZ që kundërshton, të bashkëlidhë provat në të cilat e bazon kërkimin e tij, si dhe të përshkruajë në mënyrë më të detajuar fakte dhe rrethana konkrete të çështjes, të cilat në KAS rezultojnë të paqarta.
3. Në këto kushte, me anë të vendimit nr. 132, datë 23.05.2023, KAS vendosi kthimin e kërkesës ankimore për plotësim të elementeve të formës, me një afat 24 orë, si dhe zhvillimin e seancës paraprake më datë 24.05.2023, ora 14:45.

Në përfundim të afatit të caktuar me anë të vendimit nr. 132, datë 23.05.2023, në seancën e datës 24.05.2023, ora 14:45 pas relatimit të z. Ilirjan Rusmali,

#### **KAS-i konstaton se:**

1. Ankimuesi nuk është paraqitur në seance, megjithë faktin se ai kishte dijeni rregullisht për këtë. Gjithashtu nga ankimuesi z. Lame Jaupaj nuk është bërë asnjë plotësim i kërkesës ankimore nr. 72, datë 22.05.2023 gjatë afatit të dhënë prej 24 orësh.
2. Në këto kushte, rezulton qartazi nga rrethanat se pala që ka paraqitur kërkesën nuk ka më interes për vazhdimin e procedurës. Pra, kjo kërkesë konsiderohet e braktisur në kuptim të nenit

94 të Kodit të Procedurave Administrative dhe duke qenë se vijimi i trajtimit të saj nuk përbën interes publik, KAS duket të vendosë pushimin e çështjes.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja “c” dhe në nenin 143, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

#### **V E N D O S I:**

1. Pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 72, datë 22.05.2023 të depozituar nga z. Lame Jaupaj.
2. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

U shpall sot më datë 24.05.2023.

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	<b>- Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	<b>- Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	<b>- Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	<b>- Anëtar</b>